



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:

FURNIZIMI ME MEKANIZËM BUJQËSOR- LOT II

Përkrahja e fermerëve me:

Nr.	Lloji i mekanizmit bujqësor	Sasia/copë
1	<i>Motokultivatorë me frezë 75 cm</i>	25
2	<i>Shpërndarëse plehu 300 - 350l me kardan</i>	20
3	<i>Makinë mjelëse për dy lopë</i>	27

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- 1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;**
- 2. Çertifikata e bashkësisë familjare;**
- 3. Vërtetimi i tatimit në pronë;**
- 4. Raporti i pagesave direkte/subvencioneve 2025 (vlen vetëm për paisjet 2 dhe 3);**
- 5. Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF-i.**

Përparësitë:

Poena

- | | |
|--|----|
| 1. Familjet (aplikuesit) të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit | 10 |
| 2. Numri i anëtarëve të familjes (për çdo anëtar 5 poena) | |
| 3. Përparësi të aplikimit kanë aplikuesit femra | 10 |
| 4. Aplikuesit në zonat e thella rurale | 10 |

Kushtet për aplikim

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit);
- Të jetë i/e regjistruar si fermer para datës së publikimit të thirrjes për aplikim;
- Të posedoj tokë të punueshme:
 1. Aplikuesit për **Motokultivatorë me frezë 75 cm**, të jenë kultivues të perimeve;
 2. Aplikuesit për **Shpërndarëse plehu 300 - 350l me kardan**, të ketë së paku 1 ha me tokë të punueshme;
 3. Aplikuesit për **Makinë mjelëse për dy lopë**, të ketë së paku 5 lopë.
- ❖ Fermerët përfitues do të marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit;
- ❖ Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me 70% të vlerës së projektit.

VËREJTJE: FERMERËT KANË TË DREJTË APLIKIMI VETËM NË NJËRËN NGA MEKANIZMAT E LARTËCEKUR !

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datën 25.06.2025, ora 16:00.

Nr: 12-320/01-0030745 /25

Podujevë

4 Qershor

